



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.913/ 6 prot

Datë 22/04/2025

V E N D I M
K.P.P. 531/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22/04/2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e operatorit ekonomik “Tower” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedura e hapur shërbim mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë, me kushte të pa përcaktuara”, me Nr. REF-37091-02-07-2025, me objekt “Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve te ndertimit”, me fond limit 120,182,651 (njëqind e njëzet milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH ose 1,216,916.27 Euro, bazuar në kursin e këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë të datës 06.02.2025, ku 1 Euro këmbëhet 98.76 lek, zhvilluar më datë 03.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Tower” SHPK me NIPT L21717003H me adresa: Rruga “Fadil Rada”, Pallati Daniela, Shk. 2, Kati. 3, Ap. 9, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Adresa: Rruga: “Reshit Çollaku”, Godina nr. 6/337, (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.02.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedura e hapur shërbim mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë, me kushte të pa përcaktuara”, me Nr. REF-37091-02-07-2025, me objekt “Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve të ndertimit”, me fond limit 120,182,651 (njëqind e njëzet milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH ose 1,216,916.27 Euro, bazuar në kursin e këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë të datës 06.02.2025, ku 1 Euro këmbëhet 98.76 lek, zhvilluar më datë 03.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 03.03.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.3. Në datën 19.03.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1- BOE “Engineering Consulting Group” SHPK & “G B Civil Engineering” SHPK	85,000,000	lekë kualifikuar
2- BOE “Viking Engineering” SHPK & “Erald G” SHPK	107,305,940	lekë skualifikuar
3- BOE “Infratech” SHPK & “Noor Engineering” SHPK	109,366,212.41	lekë skualifikuar
4- BOE “MAK Studio” SHPK & “EBS” SHPK & Project Daluz 2019” SHPK	112,000,000	lekë kualifikuar
5- BOE “Zenit & Co” SHPK & “Grama” SHPK & “LC-Link” SHPK	114,173,520	lekë kualifikuar
6- “Net Group” SHPK	114,175,000	lekë kualifikuar
7- BOE “Civil Cons” SHPK & “S&L Studio” SHPK	115,000,000	lekë kualifikuar
8- BOE “MCE” SHPK & “Pro Green” SHPK	115,182,651	lekë kualifikuar
9- BOE “Sire Alb” SHPK & “Invictus” SHPK & “Hydro Eng Consulting” SHPK & “Inday 18” SHPK	115,500,000	lekë skualifikuar
10- BOE “HTS Company” SHPK & “HE & SK 11” SHPK & “Magna Charta” SHPK	116,577,171	lekë kualifikuar
11- “Gjeokonsult & Co” SHPK	117,777,000	lekë kualifikuar
12- BOE “IMES-D” SHPK & “Tesla Vizion” SHPK	117,778,998	lekë kualifikuar
13- “Instituti i Konsulencës në Ndërtim IKN” SHPK	118,980,824	lekë kualifikuar
14- “Instituti Dekliada – Alb” SHPK	120,000,000	lekë skualifikuar
15- BOE “PCS Company” SHPK & “Hydrowater Albania” SHPK		

	120,000,000	lekë skualifikuar
16- BOE “Transport Highway Consulting” SHPK & MAG Partners” SHPK & “Elite Studio” SHPK & “KKG Project” SHPK	120,000,000	lekë kualifikuar
17- “Taulant” SHPK	120,000,000	lekë skualifikuar
18- BOE “CEC Group” SHPK & “Ersi/M” SHPK	120,000,000	lekë kualifikuar
19- “Studio Rebus” SHPK	120,000,000	lekë kualifikuar
20- BOE “Atelier 4” SHPK & “Hydro & Energy” SHPK	120,100,000	lekë kualifikuar
21- “A&E Engineering” SHPK	120,175,000	lekë kualifikuar
22- “Tower” SHPK	120,180,000	lekë skualifikuar
23- BOE “Sphaera” SHPK & “Derbi-E” SHPK	120,182,651	lekë kualifikuar
24- “Arena MK” SHPK	120,182,651	lekë kualifikuar
25- BOE “Arkimade” SHPK & “AVE Consulting” SHPK	120,182,651	lekë kualifikuar

II.5. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 02.04.2025 në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 07.04.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor nga ana e operatorit ekonomik “Tower” SHPK është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5220, datë 07.04.2025 dhe me Nr. 913/2025 Prot., datë 07.04.2025, për procedurën e prokurimit “Procedura e hapur shërbim mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë, me kushte të pa përcaktuara”, me Nr. REF-37091-02-07-2025, me objekt “Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve të ndertimit”, me fond limit 120,182,651 (njëqind e njëzet milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH ose 1,216,916.27 Euro, bazuar në kursin e këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë të datës 06.02.2025, ku 1 Euro këmbëhet 98.76 lek, zhvilluar më datë 03.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, me argumentat si vijon:

Në datën 19.03.2025 OE Tower shpk vihet në dijeni për skualifikimin për mospermbushje të pikës 2.3.1 të kërkesave për kualifikim, pasi “Ka paraqitur shërbime të ngjashme në vlerën 21,008,510.44 leke pa TVSH duke mos arritur të plotësojë vlerën minimale të kërkuar të shërbimeve të ngjashme prej 24,036,530.2 leke pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës me lëndë kërkesë për sqarim OE Tower shpk i drejtohet Autoritetit Kontraktor për të argumentuar më tej skualifikimin. Në shkresë vihet në dukje se OE Tower shpk ka ngarkuar gjithsej 19 përvoja të ngjashme ndër të cilat, 17 të realizuara me sektorin publik dhe 2 përvoja të realizuara me sektorin privat, me një vlerë totale prej 24,576,649.03 lekë pa tvsh dhe jo 21,008,510.44 leke pa TVSH sipas njoftimit të skualifikimit.

Në datën 28.03.2025 Autoriteti Kontraktor ngarkon në SPE shkresën me lëndë kthim përgjigje, ku detajohet mënyra e vlerësimit të shërbimeve të ngjashme nga ana e Komisionit të vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE për shërbimet e mëparshme të ngjashme të realizuara nga shoqëria juaj, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se nga përlllogaritja financiare e të gjitha faturave të paraqitura rezultojnë në një vlerë më të vogël se 24,036,530.2 lek pa t.v.sh (20 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër të kërkuar në DST). Bashkëngjitur do të gjeni tabelën përmbledhese të shërbimeve të vlerësuar nga ana e Komisionit të vlerësimit të Ofertave.

Në tabelën përmbledhëse konstatojmë se:

1-Totali llogaritet 19,824,459.5 lekë pa tvsh, dhe jo 21,008,510.44 leke pa TVSH sipas njoftimit të skualifikimit

2- Elementi kohë nuk është vlerësuar mbi objektin e përfunduar të kontratës, por mbi fatura të vecanta ndërmjetëse, duke përjashtuar nga llogaritja një pjesë të ndjeshme të shërbimeve të përfunduara brenda periudhës së vlefshme.

3- për vlerën dhe afatin e përfundimit të përvojave të realizuara me sektorin publik, Autoriteti kontraktor nuk i referohet vërtetimeve të lëshuara nga enti publik.

Mbi konstatimin e parë-mospërputhje e vlerës së llogaritur nga autoriteti kontraktor vëmë në dukje se në vendimin për skualifikim, autoriteti kontraktor ka vlerësuar se operatori ekonomik Toëer sh.p.k. Ka paraqitur shërbime të ngjashme në shumën 21,008,510.44 lekë pa TVSH, ndërsa në shkresën kthim përgjigje për të njëjtën çështje ka llogaritur një vlerë tjetër, 19,824,459.5 lekë pa TVSH.

Kjo mospërputhje tregon qartë pasiguri dhe mungesë koherence në vlerësim, duke vënë në dyshim objektivitetin dhe paanshmërinë e procesit dhe duke cenuar parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë sipas nenit 3 dhe 39 të Ligjit nr. 162/2020.

Mbi konstatimin e dytë.- Interpretimi i gabuar i periudhës kohore për kontratat e referuara

Referuar nenit 3 të Ligjit Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik , autoritetet kontraktore detyrohen të veprojnë duke garantuar trajtim të barabartë, proporcionalitet dhe transparencë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Vendimi i skualifikimit bie në kundërshtim me këto parime, pasi KVO ka zgjedhur të interpretojë periudhën 3-vjecare në mënyrë të pjesshme e të pabarabartë, duke ndarë kontratat në fatura individuale, cka ka sjellë keqlllogaritjen e vlerës së shërbimeve të ngjashme. Operatori TOWER sh.p.k ka paraqitur kontrata dhe dokumentacion që vërteton përfundimin e kontratave brenda periudhës së vlefshme 3-vjecare, sic është parashikuar në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Ndarja e kontratave në fatura të veçanta në vendimin e KVO nuk ka

mbështetje ligjore, pasi vlerësimi i përvojës duhet të bazohet në përfundimin e kontratës, dhe jo në datat e faturave ndërmjetëse. Në këtë mënyrë, KVO po penalizon operatorët që kanë pasur kontrata me zbatim të gjatë (disa mujor ose disa vjeçar), që është normale për kontrata të mëdha investimesh publike. Gjithashtu në praktikën kontraktore, shpeshherë parashikohet pagesa apo faturimi i paradhënë për shërbime që realizohen gjatë një periudhe të mëvonshme. Kjo tregon qartë se data e faturës nuk mund të merret në të gjitha rastet si referencë e saktë për përfundimin e shërbimit.

Për rrjedhojë, praktika e ndjekur nga KVO për ndarjen e kontratave në fatura individuale për efekt të vlerësimit të afatit kohor është e pabazuar dhe bie në kundërshtim me natyrën reale të ekzekutimit të kontratës, duke sjellë një vlerësim të gabuar dhe të padrejtë të përvojës së operatorit.

Mbi konstatimin e tretë.- Interpretimi ..vërtetime..ose/dhe faturaë në kërkesën e DST për provat e përvojës së mëparshme.

Në pikën 2.3.1 të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), është përcaktuar se për të vërtetuar përvojën e mëparshme me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

.....vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes...

Përdorimi i shprehjes ose/dhe nënkupton se DST i lejon operatorit ekonomik dy alternativa të pavarura ose të kombinuara për provimin e përvojës: Ose me vërtetim të lëshuar nga enti publik, Ose me fatura tatimore të shitjes, Ose me të dyja.

Ky formulim nuk kërkon detyrimisht paraqitjen e të dy formave të provës, por i jep operatorit ekonomik mundësinë të zgjedhë, sipas dokumentacionit që disponon. Në rastin konkret, operatori ekonomik Tower sh.p.k ka paraqitur vërtetime të rregullta të lëshuara nga entet publike, duke përmbushur një nga format e parashikuara të provës, e cila është e mjaftueshme sipas DST-së. Në mbështetje të argumenteve të mësipërm dhe bazuar në Ligjin nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, të ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , të ndryshuar;

Kërkojmë nga KPP:

1. Pranimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik TOWER sh.p.k.;
2. Shfuqizimin e vendimit të KVO që skualifikon operatorin ekonomik;
3. Rishikimin e ofertës sonë në procedurën e prokurimit publik REF-37091-02-07-2025, duke e konsideruar ofertën tonë si të kualifikuar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 913/1 prot., datë 08.04.2025, janë publikuar arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Tower” SHPK të cilat kundërshtohen nëpërmjetë ankesës nr. 913/2025 prot, datë 07.04.2025.

II.8. Me shkresën nr. 1146/3 prot., datë 16.04.2025, protokolluar me tonën me nr. 913/2 prot., datë 18.04.2025, me objekt “Dërgim Vendimi KSHA”, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor nr. 21/2025, datë 16.04.2025 lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Tower” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i plotë i ankesës si mëposhtë vijon:

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “TOWER” SHPK mbi vendimin e Komisionit të Vleresimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij se “[...] BOE skualifikohet për mospermbushje të pikës 2.3.1 të kërkesave për kualifikim”, KSHA vëren se:

Ne dokumentet e tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.1 e Kapacitetit teknik është percaktuar se:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë deshmi për shërbimet e meparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e spalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuader.

Per të vërtetuar pervojën e meparshme të ngjashme, operatorët ekonomike duhet të paraqesin deshmitë e mëposhtme:

- a) për pervojën e meparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetime të leshuara nga një ent publik për permbushjen me sukses të kontratës. ku të shenohen vlera, afati i perfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe shërbimet.*
- b) për pervojën e meparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet të realizuara.*

Në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Nenit 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 parashikohet se: “Ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe pervojën e nevojshme për të zbatuar kontratën

sipas nje standardi të pershshtashëm cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne veçanti, mund të kërkojnë qe operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshem përvoja qe vërtetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”.

Referuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 41 “Kërkesa te veçanta per kontratat e sherbimeve”, pika 3, parashikohet Shprehimisht se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi per realizimin me sukses të një ose disa kontratave për sherbimet e meparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës se perlllogaritur te kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve te fundit, nga data e shpalljes së njoftimit te kontrates”.

Autoritetet ose entet kontraktore, në lidhje me aftësite teknike dhe profesionale, mund të vendosin kërkesa qe garantojnë se operatorët ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme per të zbatuar kontratën sipas një standardi te pershtatshem cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund te kërkojnë qe operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshem përvoja që vërtetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomike për te ofruar sherbimin vleresohet në lidhje me aftësite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshem për te zbatuar kontratën, siç është pershkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontrates. KSHA sqaron se Mbikqyrja, në një proces ndërtimi, është një funksion i rëndesishem që ka per qellim të sigurojë që ndertimi i një objekti te kryhet në perputhje me projektin, standardet teknike, ligjet dhe rregulloret në fuqi. Ajo perfshin:

1. Kontrollin e zbatimit te projektit - Mbikëqyrësi verifikon që ndërtimi po behet sipas planit të miratuar, specifikimeve teknike dhe detajeve te projektit;
2. Sigurimin e cilësisë së punimeve - Përdorimi i materialeve të duhura dhe teknologjive të percaktuara ne projekt;
3. Zbatimin e normave ligjore dhe standardeve të sigurisë - Mbikëqyrësi kujdeset që të respektohen të gjitha rregulloret per sigurine në kantier dhe mbrojtjen e mjedisit;
4. Dokumentimin e procesit te punimeve - Përgatitja e raporteve periodike, ditari i punimeve dhe dokumentet e kontrollit te cilësisë;
5. Komunikimi me palët - Koordinimi me investitorin, projektuesit, ndërtuesin dhe autoritetet perkatese.

Pra, ne thelb, mbikqyrja është garancia qe ndertimi të bëhet siç duhet dhe pa devijime që mund të çojne në pasoja teknike, ligjore apo ekonomike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE për shërbimet e meparshme të ngjashme të realizuara nga ankimuesi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vëren se ato janë kontrata Mbikqyrje, të njëjta me objektin e kontratës së procedurës së prokurimit, objekt ankimimi.

Gjithashtu, lidhur me keto kontrata operatori ekonomik ankimues, për të vertetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, ka dorëzuar vërtetime mbi realizimin me sukses të kontratave, ku ofrohet i gjithë informacioni i kërkuar/pecaktuar nga autoriteti kontraktor në DT si vlere, afati i përfundimit të kontratës (kolaudimi) dhe natyra e shërbimit të kryer, e cila është e njëjtë me objektin e kontratës objekt prokurimi. KSHA konstaton se punët e ngjashme të realizuara nga operatori ekonomik ankimues respektojnë/plotësojnë komponentët:

- 1. “kohë” (janë përfunduar brenda tre viteve, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës);*
- 2. “vlere”, (> 20% e vlerës së fondit limit);*
- 3. “natyrë e ngjashme”, (të ngjashme me objektin që prokurohet);*

Duhet të theksojmë se kontratat e mbikqyrjes lidhen ngushtësisht me kontratat e punëve dhe si të tilla shpeshherë shkojnë përtej afateve kohore të kontratave normale të shërbimit. Ato janë të një natyre intelektuale, ku qëllimi kryesor i tyre është të sigurojnë që ndërtimi i një objekti të kryhet në përputhje me projektin, standardet teknike, ligjet dhe rregulloret në fuqi. Si i tillë ky shërbim nuk mund të vlerësohet vetëm në bazë të situacioneve pjesore por ky shërbim vlerësohet në momentin e përfundimit të objektit të ndërtimit me realizimin e akt kolaudimit dhe certifikatës së perkohshme të marrjes në dorezim të punimeve nga investitori, moment ky ku përfundojnë edhe efektet financiare të mbikëqyrësit me autoritetin kontraktor. Për më tepër, detyrat e mbikëqyrësit shtrihen përtej, duke ju nënshtruar detyrimeve ligjore edhe për periudhën e garancisë së punimeve.

Sa më sipër, KSHA gjykon se operatori ekonomik ankimues, me dokumentacionin e dorëzuar në SPE, plotëson kërkesat e pecaktuara nga autoriteti kontraktor në Dokumentat e Tenderit, duke krijuar bindjen se me aftësitë teknike dhe profesionale, zotëron burimet dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësie.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për keto arsye

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

Vendosi

- 1- Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “TOWER” shpk.*

- 2- *Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre ankimuesin, Brenda dites se nesërme te punis nga marrja e këtij vendimi.*
- 3- *Personi pergjegjës per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre operatorët ekonomike te interesuar, brenda ditës se nesërme te punes nga marrja e këtij vendimi.*
- 4- *Personi pergjegjës per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, brenda dites se nesërme te punes nga marrja e kitij vendimi, duke e shogëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin perkatës.*
- 5- *Ky vendim i njoftohet menjehere Titullarit te Organit Qendror Blerës.*

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ nuk rezulton, të jenë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Tower” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën nr. 1146/3 prot., datë 16.04.2025, protokolluar me tonën me nr. 913/2 prot., datë 18.04.2025, me objekt “*Dërgim Vendimi KSHA*”, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor nr. 21/2025, datë 16.04.2025 lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Tower” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i plotë i ankesës si mëposhtë vijon:

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “TOWER” SHPK mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave per skualifikimin e ofertës se tij se “[...] BOE skualifikohet per mospermbushje te pikes 2.3.1 te kerkesave per kualifikim”, KSHA vëren se:

Ne dokumentet e tenderit, Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, pika 2.3.1 e Kapacitetit teknik eshte percaktuar se:

“Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per sherbimet e meparshme te ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e spalljes se njoftimit te kontratës, ne nje vlere jo me të vogel se 20 % të vleres se fondit te limit te marrëveshjes kuader.

Per të vërtetuar pervojën e meparshme të ngjashme, operatorët ekonomike duhet të paraqesin deshmitë e mëposhtme:

- c) për pervojën e meparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetime të leshuara nga një ent publik per permbushjen me sukses te kontrates. ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates, ose/dhe faturave tatimore te shitjes, te plotësuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet.*
- d) per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqese fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kerkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Nenit 77 “Kërkesat per kualifikim”, pika 4 parashikohet se: “Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, auoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kerkesa që garantojne se operatorët ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme per te zbatuar kontratën sipas nje standardi të pershshtashëm cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne veçanti, mund të kërkojne qe operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshem përvoje qe vërtetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”.

Referuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 41 “Kërkesa te veçanta per kontratat e sherbimeve”, pika 3, parashikohet Shprehimisht se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi per realizimin me sukses të një ose disa kontratave për sherbimet e meparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës se perlllogaritur te kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve te fundit, nga data e shpalljes së njoftimit te kontrates”.

Autoritetet ose entet kontraktore, në lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, mund të vendosin kërkesa qe garantojnë se operatorët ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe pervojën e nevojshme per të zbatuar kontratën sipas një standardi te pershtatshem cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund te kerkojnë qe operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshem pervoje që vërtetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomike për te ofruar sherbimin vleresohet në lidhje me aftësite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojën e duhur, si dhe personelin e nevojshem për te zbatuar kontratën, siç është pershkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontrates. KSHA sqaron se Mbikqyrja, në një proces ndërtimi, është një

funksion i rëndësishëm që ka për qëllim të sigurojë që ndërtimi i një objekti të kryhet në përputhje me projektin, standardet teknike, ligjet dhe rregulloret në fuqi. Ajo përfshin:

- 1. Kontrollin e zbatimit të projektit - Mbikëqyrësi verifikon që ndërtimi po bëhet sipas planit të miratuar, specifikimeve teknike dhe detajeve të projektit;*
- 2. Sigurimin e cilësisë së punimeve - Përdorimi i materialeve të duhura dhe teknologjive të përcaktuara në projekt;*
- 3. Zbatimin e normave ligjore dhe standardeve të sigurisë - Mbikëqyrësi kujdeset që të respektohen të gjitha rregulloret për sigurinë në kanton dhe mbrojtjen e mjedisit;*
- 4. Dokumentimin e procesit të punimeve - Përgatitja e raporteve periodike, ditari i punimeve dhe dokumentet e kontrollit të cilësisë;*
- 5. Komunikimi me palët - Koordinimi me investitorin, projektuesin, ndërtuesin dhe autoritetet përkatëse.*

Pra, në thelb, mbikqyrja është garancia që ndërtimi të bëhet siç duhet dhe pa devijime që mund të çojnë në pasoja teknike, ligjore apo ekonomike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE për shërbimet e mëparshme të ngjashme të realizuara nga ankimuesi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vëren se ato janë kontrata Mbikqyrje, të njëjta me objektin e kontratës së procedurës së prokurimit, objekt ankimimi.

Gjithashtu, lidhur me këtto kontrata operatori ekonomik ankimues, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, ka dorëzuar vërtetime mbi realizimin me sukses të kontratave, ku ofrohet i gjithë informacioni i kërkuar/përcaktuar nga autoriteti kontraktor në DT si vlera, afati i përfundimit të kontratës (kolaudimi) dhe natyra e shërbimit të kryer, e cila është e njëjtë me objektin e kontratës objekt prokurimi. KSHA konstaton se punët e ngjashme të realizuara nga operatori ekonomik ankimues respektojnë/plotësojnë komponentët:

- 1. “kohë” (janë përfunduar brenda tre viteve, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës);*
- 2. “vlerë”, (> 20% e vlerës së fondit limit);*
- 3. “natyrë e ngjashme”, (të ngjashme me objektin që prokurohet);*

Duhet të theksojmë se kontratat e mbikqyrjes lidhen ngushtësisht me kontratat e punëve dhe si të tilla shpeshherë shkojnë përtej afateve kohore të kontratave normale të shërbimit. Ato janë të një natyre intelektuale, ku qëllimi kryesor i tyre është të sigurojnë që ndërtimi i një objekti të kryhet në përputhje me projektin, standardet teknike, ligjet dhe rregulloret në fuqi. Si i tillë ky shërbim nuk mund të vlerësohet vetëm në bazë të situacioneve pjesore por ky shërbim vlerësohet në momentin e përfundimit të objektit të ndërtimit me realizimin e akt kolaudit dhe certifikatës së përkohshme të marrjes në dorezim të punimeve nga investitori, moment ky ku përfundojnë edhe efektet financiare të mbikëqyrësit me autoritetin kontraktor. Për më tepër, detyrat e mbikëqyrësit

shtrihen pertej, duke ju nënshtruar detyrimeve ligjore edhe për periudhen e garancise së punimeve.

Sa më sipër, KSHA gjykon se operatori ekonomik ankimues, me dokumentacionin e dorëzuar në SPE, ploteson kerkesat e percaktuara nga autoriteti kontraktor ne Dokumentat e Tenderit, duke krijuar bindjen se me aftesite teknike dhe profesionale, zotëron burimet dhe pervojën e nevojshme per të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshem cilësie.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për keto arsye

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankesës,

Vendosi

- 1- Pranimin e plotë te ankesës se paraqitur nga operatori ekonomik “TOWER” shpk.*
- 2- Personi pergjegjes per prokurimin të njoftoje per vendimin e marre ankimuesin, Brenda dites se nesërme te punis nga marrja e këtij vendimi.*
- 3- Personi pergjegjës per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre operatoret ekonomike te interesuar, brenda ditës se nesërme te punes nga marrja e këtij vendimi.*
- 4- Personi pergjegjës per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, brenda dites se nesërme te punes nga marrja e kitij vendimi, duke e shogeluar me shpjegimet dhe dokumentacionin perkatës.*
- 5- Ky vendim i njoftohet menjehere Titullarit te Organit Qendror Blerës.*

II.1.2. Neni 30, e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115, pika 1 dhe 2, e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimes në lidhje me arsyet e tij të skualifikimit, rezultojnë të jenë pranuar plotësisht nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu referuar dhe materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezulton, të jenë paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Tower” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedura e hapur shërbim mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë, me kushte të pa përcaktuara”, me

Nr. REF-37091-02-07-2025, me objekt “Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve të ndertimit”, me fond limit 120,182,651 (njëqind e njëzet milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH ose 1,216,916.27 Euro, bazuar në kursin e këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë të datës 06.02.2025, ku 1 Euro këmbëhet 98.76 lek, zhvilluar më datë 03.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

2. Autoriteti kontraktor të kryej rivlerësimin e procedurës në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 21, datë 16.04.2025, dhe të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Tower” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

